



**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
PARATEL**

**DATË 15/03/2018**

**KREU I  
THEMELIMI, EMRI, FORMA LIGJORE, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

**Neni 1**

**THEMELIMI**

Sot më datë 15/03/2018, z. Florian Molla, Shtetas Shqiptar, lindur më 27/ 04/ 1980 në Bushat, Shkodër, Shqipëri, me Nr. ID 100427124A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhez. Maurizio Budau, Shtetas Italian, lindur më 05/ 04/ 1974 në Orbassano, me Nr.ID AV8534220, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar kanë vendosur të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të mëposhtme.

**Neni 2**

**EMRI, FORMA LIGJORE**

1. Emri i shoqërisë është PARATEL Sh.p.k. (më poshtë referuar si Shoqëria).
2. Shoqëria është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
3. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Aktiviteti i Shoqërisë do të ushtrohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të paraqitura në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

### **Neni 3**

#### **SELIA**

1. Selia e ushtrimit të aktivitetit tregtar të Shoqërisë është në Njesinë Bashkiake Nr. 2, në Rrugën Bajram Curri, Kati i I, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri.
2. Shoqëria mund të themelojë degë të tjera dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitave të këtij Akti Themelimi dhe Statuti.

### **Neni 4**

#### **OBJEKTI**

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është:

1. Të operojë në sektorin e telekomunikacionit duke kryer çdo lloj veprimtarie nëpërmjet telefonit për llogari të vet apo të tretëve me seli në Shqipëri apo në çdo vend tjetër që ka lidhje me Republikën e Shqipërisë, duke respektuar ligjin në fuqi.
2. Të kryejë aktivitete nëpërmjet telefonit të çdo lloji për llogari të vet apo të tretëve, telemarketing, sekretari telefonik, shitje nëpërmjet telefonit, sondazhe promovionale dhe çdo lloj tjetër aktiviteti të lidhur me të, ku persona përmendur më sipër nuk mund të jete saktësisht apo të kufizuar, të blejë e të shesë ose të japë me qera, në përdorim, në uzufukt ose në shfrytëzim pasuri të luajtshme e pasuri të paluajtshme të regjistruara në regjistrat publike.
3. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të afert me të vetin.
4. Çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 5**

### **KOHËZGJATJA**

1. Shoqëria themelohet dhe do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## **KREU II**

### **KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KUOTA**

## **Neni 6**

### **KAPITALI THEMELTAR DHE ORTAKËT**

1. Kapitali Fillestar Themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) lekë dhe zotërohet nga Ortakësi më poshtë:
  - z. Florian Molla, është zotëruar i 50% të kapitalit me vlerë 50 (Pesëdhjetë) lekë, e barabartë me 1 kuotë.
  - z. Maurizio Budau, është zotëruar i 50% të kapitalit me vlerë 50 (Pesëdhjetë) lekë, e barabartë me 1 kuotë.
2. Ortakët e i Shoqërisë përgjigjen për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.

## **KREU III**

### **ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

## **Neni 7**

### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

1. Asambleja e përgjithshme, ligjrisht e thirrur, dhe në mënyrë të rregullt e mbledhur, është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e marra prej saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitave të këtij Akti Themelimi dhe Statuti, janë për t'u zbatuar dhe ndjekur në mënyrë të detyrueshme.
2. Asambleja e përgjithshme ka këto funksione dhe përgjegjësi:

- përcaktimin e politikave tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga Administratori i Shoqërisë përfshirë dhe raportimet financiare të Shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e Administratorit(-eve);
- emërimin dhe shkarkimin i likuiduesit(-ve) dhe të ekspertit(-ëve) kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve për Administratorin(-et), likuiduesin(-in) dhe ekspertin(-ët) kontabël të autorizuar;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
- vendimin për ndryshimet në këtë Akt Themelimi dhe Statut;
- vendimin për zmadhim ose zvogëlim të kapitalit;
- vendimin për shpërndarjen e fitimeve, dividendëve;
- vendimin për pjesëtimin e kuotave;
- vendimin për hapjen e degëve të tjera dhe/ ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë;
- vendimin për krijimin e marrëveshjeve që lidhen me shitjen, blerjen, pjesëmarrjen dhe investimin në projekte ekzistuese dhe të reja;
- vendimin për dhënien dhe marrjen e huasë për financim biznesi;
- marrjen e vendimit për blerje të pasurive të paluajtshme;
- vendimin për bllokimin dhe lënien peng të pasurive të paluajtshme pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- marrjen e vendimit për prishjen dhe likuidimin e Shoqërisë;
- miratimin dhe mbikëqyrjen e ndjekjes dhe zbatimit të buxhetit vjetor;
- miratimin e çdo shpenzimi dhe/ose investimi, të cilat nuk janë parashikuar në buxhetin vjetor;
- miratimin e planit të kontrollit të brendshëm, nëse konsiderohet e nevojshme;
- marrjen e vendimit për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji shqiptar.

## Neni 8

### MBLEDHJET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin,

datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, atëherë ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm kur të gjithë ortakët janë dakord të marrin vendim, pavarësisht parregullsisë.
3. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga një a më shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë.
3. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.
4. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbliidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, Asambleja mbliidhet përsëri, jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

##### **REGJISTRIMI I VENDIMEVE**

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit janë të pandryshueshme. Regjistri i Vendimeve duhet të mbahet nga Administratori dhe çdo regjistrim nënshkruhet prej tij.

#### **Neni 10**

##### **MANDATI DHE TË DREJTAT E PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT**

1. Shoqëria administrohet nga 3 (tre) Administratorë, 2 (dy) nga të cilët mund të veprojnë pa asnjë kufizim dhe 1 (një) me kufizime.
2. Administratorët e Shoqërisë janë:
  - z. Florian Molla, Shtetas Shqiptar, lindur më 27/ 04/ 1980 në Bushat, Shkodër, Shqipëri, me Nr. ID I00427124A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,


- z. Maurizio Budau, Shtetas Italian, lindur më 05/ 04/ 1974 në Orbassano, me Nr. ID AV8534220 madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe
- z. Elio Zyka, Shtetas Shqipëtar, lindur më 17/03/1995 në Çorovodë, Skrapar, me Nr. ID J50317090K madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

3. Mandati i Administratorit është 5 (pesë) vjet, i rinovueshëm, dhe zgjatet deri në vendimin pasardhës të Asamblesë së Përgjithshme, që vendos për revokimin, rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit(-eve) të ri.

4. Shoqëria prezantohet ndaj të tretëve nëpërmjet Administratorit.

5. Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- Administron veprimtarinë e Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
  - Përfaqëson Shoqërinë në palët e treta.
  - Merr masa në hartimin dhe ruajtjen e pasqyrave financiare dhe dokumentacionit të Shoqërisë në mënyrën e duhur.
  - Përgatit pasqyrat financiare vjetore dhe bilancet, përgatit raportin e ecurisë së veprimtarisë.
  - Harton dhe implementon sistem paralajmerimi mbështetur në rreziqet që kërcënojnë veprimtarinë.
  - Përfaqëson Shoqërinë në Qendrën Kombëtare të Biznesit duke dorëzuar dokumentat me të dhënat e kërkuara përveç rastit kur ligji parashikon ndryshe.
  - Raporton tek Asambleja e Përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare.
  - Kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar në legjislacion, Aktin e Themelimit dhe Statut.
6. Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një procedure një person të tretë për të përfaqësuar Shoqërinë.
7. Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërbushjes së përgjegjësive të parashikuara në Statut dhe legjislacionin në fuqi.
8. Administratori, i cili mund të veprojë me kufizime z. Elio Zyka, ka vetëm këto të drejta dhe përgjegjësi:
- Të aplikojë për regjistrimin fillestar të biznesit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
  - Të hapë llogari bankare në emër të shoqërisë.
  - Të kryejë pagesat ndaj punonjësve.
  - Të kryejë depozitime në bankë për llogari të shoqërisë.

- 
- Të kryejë pagesa kundrejt institucioneve publike.
  - Të lidhë kontrata me punonjës dhe kontrata bashkëpunimi me furnitorët.
  - Të kryejë pagesa kundrejt llogarive të ortakëve.

**KREU IV**  
**VITI FINANCIAR- SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

**Neni 11**  
**VITI FINANCIAR**

1. Përveç vitit të parë të aktivitetit që fillon nga data e themelimit të Shoqërisë, viti financiar fillon në datën 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor.

**Neni 12**  
**SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

1. Pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimit, nëse ka.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
  - aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

**KREU V**  
**PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

**Neni 13**  
**PRISHJA DHE LIKUJDIMI**

1. Në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos për prishjen e Shoqërisë, do të emërojë një ose më shumë likuidues.

2. Prishja dhe likuidimi kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**KREU VI**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**


**Neni 14**  
**BAZA LIGJORE**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**\* PARATEL\***

BUDAU MAURIZIO

(Emër, mbiemër, nënshkrim)



FLORIAN MOLLA

(Emër, mbiemër, nënshkrim)

